

**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
*REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA*  
**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
OSNOVNI SUD PRIŠTINA – BASIC COURT OF PRISTINA

---

**PRKR.nr.179/15**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA** – në trupin gjykues të përberë nga gjyqtarja Shadije Gërguri- kryetare e trupit, gjyqtarëve Beqir Kalludra dhe Mustafë Tahiri si anëtarë të trupit gjykues me bashkëpunëtorin Driton Berisha, në lëndën penale kundër të akuzuarëve Q.I.dhe H.N.për shkak të veprës penale të kryer në bashkëkryerje Marrja e ryshfetit nga neni 343 par.2 lidhur me nenin 23 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.nr.6766/2012, të dt 30.10.2012, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësorë, në të cilën kanë marrë pjesë prokurorja Merrushe Llugiqi, të akuzuarit Q.I.dhe H.N.me mbrojtësin av. B.Sh. sipas autorizimit, me dt:12.06.2018, mori dhe publikisht shpalli:

**A K T G J Y K I M**

**TË AKUZUARIT:**

**Q.I.**nga i ati R. dhe e ema H.1, i vajzerise K.1, i lindur me ... fsh. 'K.2' KK-P.1, tani me vendbanim në P.2 lagjja U. hyrja ... nr...., ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë i martuar baba i ... fëmijëve, i gjendes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**H.N.**nga i ati L. dhe e ema H.2, i vajzërisë Sh., i lindur me ... fsh.'B.' KK P.1 tani me vendbanim F.K. rr.'A.' p.n., ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i martuar, baba i ... fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**JANË FAJTOR**

**SEPSE:** me dt.20.10.2012, rreth orës 11:00, në magjstralën Prishtinë – Pejë në fshatin Ll. KK-G., në pozitën e pjesëtarëve të policisë së Kosovës – Njësia e Trafikut Rajonal – patrullës, të akuzuarit Q.I.dhe H.N., deri sa ishin duke kryer detyrën e tyre zyrtare kanë ndaluar D.R. ashtu që për shkak të tejkalimit të shpejtësisë, të njëjtit i kanë shqiptuar gjobën 270 euro, mirëpo pas lutjeës së të njëjtit për mosshqiptimin e gjobës, të akuzuarit Q.I.dhe H.N., kanë kërkuar dhe marr në emër të ryshfetit shumë e të hollave prej 50 €, nga i dëmtuari D.R., dhe me atë rast tikëtën e shqiptuar e kanë anuluar.

- me këtë në bashkëveprim kanë kryer veprën penale Marrja e ryshfetit nga neni 343 par.2 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Andaj gjykata në kuptim të neneve 3,4,41,42,43,45,73 të KPK-së dhe nenit 365 dhe 450 të KPPK-së, i'u shqipton:

Të akuzuarit **Q.I.** për veprën penale Marrja e ryshfetit në bashkëkryerje nga neni 343 par.2 lidhur me nenin 23 të KPK-së, **DENIM ME BURGIM**, në kohëzgjatje prej **3 (tre) muaj**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse I njëjti në periudhën prej 1 viti nuk kryen vepër tjetër penale.

Të akuzuarit **H.N.** për veprën penale Marrja e ryshfetit në bashkëkryerje nga neni 343 par.2 lidhur me nenin 23 të KPK-së, **DENIM ME BURGIM**, në kohëzgjatje prej **3 (tre) muaj**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse I njëjti në periudhën prej 1 viti nuk kryen vepër tjetër penale.

I dëmtuari D.R. për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike udhëzohet në kontest civil.

Të akuzuarit Q.I.dhe H.N.obligohen të paguajnë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë të kësaj gjykate, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej nga **50 (pesëdhjetë) Euro** secili veç e veç, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

### **Arsyetim**

Prokuroria Komunale në Prishtinë me propozimin akuzues PP.nr. 6766/12 të datës 30.10.2012, e ka akuzuar Q.I. dhe H.N. për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Marrja e ryshfetit nga neni 343 par.2 lidhur me nenin 23 të KPK-së duke propozuar që të njejtit të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit.

Kjo Gjykata me aktgjykimin PKR. 159/13 të dt:07.05.2014 të akuzuarit Q.I.dhe H.N.i ka shpallur fajtor, dhe ju ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 8 muajve, ndërsa që Gjykata e Apelit me aktvendimin PAKR nr.647/14 të dt:20.03.2015 ka vendosur prishjen e aktgjykimit dhe kthimin e çështjes në rivendosje.

Prokurorja e shtetit Mirushe Llugiqi në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pas administrimit të provave dhe dëshmimeve, dëgjimit të dëshmitarëve si dhe leximit të deklaratos së të dëmtuarit D.R.të dhënë në stacionin policorë, në mënyrë të qartë dhe bindëse, është vërtetuar se Q.I.dhe H.N.kanë kryer veprën penale ashtu siç është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës.

I akuzuari Q.I., në fjalën përfundimtare të paraqitur në formë të shkruar dhe të elaboruar gojarisht ka pretenduar se i gjithë procesi gjyqësor kundër tij ka filluar në bazë të një deklarate të dhënë nga tani I dëmtuari D.R. I cili ka keqpërdorur kërkesën e tij që I njëjti të kthehet në vendin e ngjarjes për të marrë tiketën pas 2 ore pasi që për shkak të një aksidenti dhe nevojës për intervenim ka qenë e pamundshme që e njëjta të dorëzohet në momentin e konstatimit të veprimit kundërvajtës ndërsa që I njëjti me qëllim të ikjes së shqiptimit të dënimit ka shkuar në polici duke pretenduar se kinse bashkë me kolegun e tij tani të akuzuarin H.N. I kanë kërkuar 50 euro me qëllim që të mos i shqiptojnë kundërvajtje. Më tutje ka shtuar se lidhur me kredibilitetin e këtij dëshmitari flet fakti i refuzimit të tij për tu

paraqitur në gjykatë dhe për të dëshmuar lidhur me ngjarjen në këtë çështje penale, ndërsa që sa i përket deklaratave që I njëjti ka dhënë në procedurë paraprake i njëjti nuk ka arritur ta identifikojë tani të akuzuarin si zyrtarin policor i cili ka kërkuar shumën e parave mirëpo edhe nëse gjykata vendos që këtyre deklaratave t'ua fal besimin, të njëjtat nuk mund ti merr si bazë për gjetjen e të njëjtit fajtor duke pasur parasysh nenin 262 të KPPK-së i cili ka paraparë se askush nuk mund të shpallet fajtor duke u mbështetur vetëm në një dëshmi ose duke i dhënë rëndësi vendimtare një dëshmie e cila nuk mund të kundërshtohet nga i pandehuri ose mbrojtësi i tij, e po ashtu edhe sa i përket dëshmitarve tjerë të njëjtit në deklaratimet e tyre nuk kanë përmendur asnjë veprim inkriminues të këtij të akuzuari.

Mbrojtësi i të akuzuarit H.N., av. B.Sh. në fjalën përfundimtare të paraqitur me shkrim dhe të elaboruar gojarisht pretendon se provat e siguruara gjatë marrjes në pyetje në procedurën paraprake nuk mund të përdoren si prova të drejtëpërdrejta gjatë shqyrtimit gjyqsorë, por mund të përdoren gjatë marrjes së tërthortë në pyetje për vënien në dyshim të dëshmisë së dëshmitarit dhe se edhe gjykata e apelit me rastin e kthimit të çështjes në rivendosje e ka obliguar këtë gjykatë që dëshmitarët D.R. të dëgjohet si dëshmitar në shqyrtim gjyqsor, ndërsa që nuk ka prova se i njëjti është tentuar për tu dëgjuar në këtë cilësi. Më tutje ka shtuar se deklarata e cila është lexuar si provë nga i dëmtuari është dhënë në gjuhën serbe duke mos u përkthyer në gjuhën shqipe, gjuhë të cilën të akuzuarit e flasin dhe e kuptojnë, ndërsa që nëse shikohet procesverbali i deklaratës së palës së dëmtuar i dt: 20.10.2012 i filluar në ora 12:35 dhe i përfunduar në ora 13:00 mund të kuptohet se në atë deklaratë kanë shënuar 2 persona gjegjësisht deri në fund të deklaratës është shkrimi i një personi, ndërsa që në fund të tekstit shihet se fjalët janë shkruar nga një person tjetër, ndërkaq edhe nënshkrimi i të dëmtuarit në fillim dhe fund të faqës nuk është i njëjtë. Po ashtu ka shtuar se edhe gjatë rastit të dhënies së deklaratës në polici nga ana e e palës së dëmtuar nuk kanë qenë prezent 2 avokatët e caktuar sipas detyrës zyrtare pasi që asnjëri prej tyre nuk është nënshkruar në procesverbalin e lartcekur, mirëpo që vetëm janë shënuar emrat dhe numrat e ID-ve të së njëjtëve. Andaj, nga se u tha më lartë ka kërkuar që mbrojturi i tij të lirohet nga akuza për veprën penale për të cilën është akuzuar.

Gjykata pas vlerësimit të provave të proceduara secilën veç e veç dhe të gjitha provat bashkarisht konform nenit 361 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së ka vërtetuar këtë gjendje faktike se me datën 20.10.2012 rreth orës 11.00 në magjistratën Prishtinë – Pejë në fshatin Ll. KK G., në pozitën e pjesëtarëve të policisë së Kosovës-njësia e trafikut rajonal- patrullës të pandehurit Q.I.dhe H.N.në bashkëveprim, kanë kërkuar dhe marrë në emër të ryshfetit shumën e të hollave prej 50 euro nga i dëmtuari D.R., me rast të njëjtit nuk i kanë shqiptuar tiketë ndëshkuese, për shkak të kundërvajtjes së shkaktuar në komunikacion.

Gjendjen e këtillë faktike gjykata e ka vërtetuar në bazë të deklaratave të dëshmitarve V.V., Sh.A., H.K., në bazë të leximit të deklaratës së të dëmtuarit D.R., listes së dëshmimeve të datës 20.10.2012 dhe në bazë të raporteve policore të dt. 20.10.2012 .

Nga deklarata e dëshmitarit V.V. të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqsor 26.12.2013 është vërtetuar se ditën kritike me kolegun Sh.A. dhe H.K. pas marrjes së informatës se një njësi e trafikut në fshatin Ll. nga një qytetar i Maqedonisë kanë marrë 50 euro dhe pasiqë rastin e ka lajmëruar në inspektorat sipas udhëzimeve të marra nga shefi ka shkuar në vendin e ngjarjes. Fillimisht kanë shkuar në fshatin Ll., mirëpo aty nuk i kanë gjetë, e pastaj duke shkuar në drejtim të K. i kanë vërejtëdy policë në rrugë, njëri ka qenë në veturë, ndërsa tjetri

jashta veturës dhe menjëherë i kanë njoftuar për arsyen e ardhjes, për kontrollën dhe intervistimin që duhet bërë, aty në vendin e ngjarjes. Më tutje tani të akuzuarit, të gjitha sendet qëi kanë poseduar me veti i kanë vendosur mbi veturë, ndërsa që kanë vendosur për shkak që të njëjtit kanë qenë zyrtar policor, kontrolli i trupit të tyre të mos bëhet në vendin e ngjarjes dhe së bashku me të akuzuarin Q.I. janë nisur me veturën zyrtare në drejtim të stacionit policor dhe gjatë rrugëtimit i'u është kërkuar nga kolegët H.3 dhe Sh. të kthehet në vendin e ngjarjes dhe kur është kthyer I është thënë nga Sh. se tani i akuzuari H.3 e ka hapur derën e veturës dhe e ka pytur a bënë të pshtyjë dhe në atë moment e ka hedhur një letër jashtë veturës, ndërsa që kur janë afruar tek e njëjta kanë vrejtur që është monedhë në shumë prej 50 euro, të cilat I kanë fotografuar me telefon dhe në atë moment i akuzuari H.3 i është drejtuar me fjalët “Rreshter çka me bo tash” ndërsa që ky i është përgjigjur se skemi çka me bo tash dhe përsëri i akuzuari H.3 i është drejtuar tani dëshmitarit me fjalët “Fol, qele gojën”, ndërsa që ky i është përgjigjur se ka marrë fund gjithçka, duhet të nisemi në stacionin policor në D.. Po ashtu ka shtuar se gjatë kontrollit të të akuzuarit H.3, i janë gjetur një shumë parash të cilat ka pasur të vendosura në kuletë dhe pas numrimittë të njëjtave kanë rezultuar të jenë 14.700 euro, dhe përsëri i janë kthyer të akuzuarit H.3 i cili ka pohuar se arsyeja se këtë shumë parash mbanë më vete është fakti se nuk ka siguri në banka. Po ashtu ka shtuar se tiketa që është gjetur në afërsi ka qenë e nënshkruar nga tani i akuzuari Q.I..

Nga leximi i dëshmisë së dëshmitarit Sh.A. të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt:26.02.2014, e cila dëshmi është lexuar me pajtim të palëve në procedurë, është vërtetuar se I njëjti në vitin 2012 kur ka ndodhur rasti ka qenë në cilësinë e zyrtarit policor në stacionin policor në D. në njësinë reaguese dhe se ditën kritike së bashku me rreshetrin V.V. ka shkuar te vendi I ngjarjes, në grykën e Ll., në fshatin Ll. sipas informatës të marrë nga udhëheqësi I tij, dhe me rastin e arritjes në vendin e ngjarjes ka takuar dy policët ku njëri ishte duke u marrur me matjen e shpejtësisë së levizjes së automjeteve, ndërsa tjetri ishte afër veturës, me të njëjtit nuk ka komunikuar faredhe se në momentin kur ka dalë nga vetura zyrtare i shoqëruar nga H.K. e ka vërejtur një kartëmonedhë prej 50 euro, e njëjta ka qenë e hudhur jashta automjetit, në tokë. Po ashtu ka shtuar se për të gjitha veprimet e tija ka përpiluar një raport i cili mbanë datën 20.10.2012 dhe pas ofrimit në vështrim të të njëjtit ka deklaruar se po ky është raporti që ka përpiluar dhe qëndron në tërësi pranë të njëjtit.

Nga leximi i dëshmisë së dëshmitarit H.K. të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt:26.02.2014, e cila dëshmi është lexuar me pajtim të palëve në procedurë është vërtetuar se pas marrjes së informatës nga rr. V.V. i cili kishte pranuar një ankësë nga një person i cili nuk ishte shtetas i Kosovës, së bashku kanë shkuar në vendin e ngjarjes ku i kanë takuar tani të akuzuarit Q. dhe H.3, njëri ka qenë brenda në veturë, ndërsa tjetri ka qenë duke e matur shpejtësinë e levizjes së automjeteve me llaser. Më tutje ka shtuar se ka marrë në pyetje Q. brenda në veturën e tyre zyrtare dhe i njëjti në tërësi e ka mohuar se ka kryer ndonjë veprim të paligjshëm dhe me këtë rast është përpiluar edhe procesverbal ndërsa që me kërkesën e mbikqyrësit me të njëjtin janë nisur në stacionin policor në D., kun ë veturë ka qenë dëshmitari , kolegu i tij Sh.A., dhe për një moment i akuzuari H.N.ka kërkuar ta hap derën e veturës për të pshtyer dhe në atë cast kolegu Sh.A. ka kërkuar që ta ndalë veturën, ka dal nga vetura dhe i ka thënë dëshmitarit “Kqyre paret ku gujti” dhe kur dëshmitari ka dalur nga vetura ka vërejtur një kartëmonedhë prej 50 euro e cila ka qenë 2 metra larg veturës dhe me atë rast kolegu Sh.A. e ka njoftuar rr. V.V. të cilit i ka kërkuar që të kthehet në vendin e ngjarjes dhe se dëshmitari I vetëm ka bërë fotografimin e monedhës në shumë prej 50 euro

dhe se po ashtu ka hartuar procesverbalin lidhur me Shumen e të hollave prej rreth 13.000 euro të cilat I ka poseduar tani I akuzuari H.N..

Nga deponimi i deklaratës të dëmtuarit D.R.të dhënë në Polici me dt.20.10.2012, është vërtetuar se me datën 20.10.2012 në rrugën Prishtinë-Pejë, tek fshati Ll. e ka ndalë policia, saktësisht dy policë të cilët e kanë poseduar radarin dhe i kanë thënë se ka drejtuar veturën mbi 97 km/h dhe e ka përpiluar raportin në të cilin I ka shënuar shënimet e tij si dhe denimin prej 270 euro. I dëmtuari ka refuzuar me nënshkru procesverbalin duke thënë se nuk e ka drejtuar veturën mbi 97 km, por dikun 80 km/h. Policët i kanë treguar se nëse nuk e nënshkruan procesverbalin, duhet landa me shku ne gjykatë dhe bëhen edhe shpenzime tjera. Poashtu kanë thënë se në Kosovë denimet paguhet krejt përnjëherë e pastaj I njejtju ka thënë se denimi është i lartë dhe në të njejtën kohë ka lut me e zvoglu denimin, meqenëse nuk e ka drejtuar veturën me atë shpejtësi. Policët mes veti janë marrë vesh nuk e ka kuptua, e pastaj njëri prej këtyre që ka qenë në veturë i ka thënë se duhet me qarosë një drekë të mirë,ku këtë i njejtju e ka pranuar dhe ka shkuar deri te vetura i ka marrë 50 euro dhe polici në veturë ka marrë ato të holla dhe e ka grisur procesverbalin.

Nga raporti I zyrtarit policor H.K,është vërtetuar se me dt.20.10.2012 rreth ores 11;38rr. V.V. e ka njoftuar se është raportuar një rast së marjes së mitos nga personat zyrtarë, të trafikut regjional. Me rastin e ardhjes në vendin e ngjarjes në fshatin Ll. i kanë takuar një patrullë të policisë e përbërë nga dy policë,H.N. dhe Q.I.Të njejtju i kanë njoftuar se janë të autorizuar mi ndërmarë të gjitha veprimet hetimore,sepse janë të dyshuar për veprën penale të marjes së mitos. Për ta siguruar provat materjale kanë kërkuar nga ata që të gjitha sendet që i kanë në posedimi mi nxjer nga xhepa.E dinë se H.N.atë ditë me veti i ka poseduar 13.870 Euro, ndersa Q. 50 Euro në apoe (1x20 , 3x10 ). Në vendin e ngjarjes i kanë intervistuar të dyshimtit, e pastaj kanë vendosëqë të shkojnë në stacionin policor në G. për të vazhduar me ndermarjen e veprimeve hetimore. Në vetyren e tyre zyrtare ka hyre H.3 dhe i njejtju ka qenë i ulur nëulësen e prapme. Rr. e ka ndezë veturen dhe ende pa u nisë e ka ndigjue se i dyshimti H.3 e ka pytë kolegun Sh. së aka mundësi me hapë deren dhe me pshty, kolegu ia ka mundësue , mirpo mas mbulljes së deres kolegu Sh. ka kërkuar mu ndal , ka dal nga vetyra duke kaluar nga ana e H.3 dhe menjherë e ka thire edhe rr. H. dhe kur është afruar tek rr. Sh. aj e njoftoi se H.3. I ka gjuajtur një monedhë prej 50 Euro, të njejtat kanë qenë të ndrydhura . Në momentin kur e ka pytë dëdyshimtin H.3 kujtjanë këto parë, H.3. itha “pash zotin mos e botë madhe këtë punë se po ja bojmë diqysh kësaj pune e ju kolegë mos na boni këtahen se kam fëmi dhe e hupi punen, ndersa rreshteri ju ka përgjigjë se nuk banë kyrqysh dhe nese e hupë punen, e hupë si pasojë e veprimeve tuaja”. Të gjitha i ka shenuar në këtë rraport dhe në tërsi ka mbetë pranëkëtij rraporti tëcilen në fund e ka nënshkruar.

Nga raporti i oficerit V.V. të dt. 20.10.2012 është vërtetuar, se sipas informates se një qytetari të shtetas i Maqedonisëderi sa ishte I ndalur nga një patrullë në fsh.Ll. nga ai I kishin marrë 50 euro.Ka vendosë që së bashku me kolegun H.K.ti merrë të gjitha veprimet policore sa I përket rastit. Kur kanë ardhë në fshatin Ll. aty i kanë takuar një patrullë policore, të trafikut regjional me vetyre zyrtare “Golf V” me ... se bashku policët H.N. dhe Q.I. dhe i kanë njoftuar për arsyeren e ardhjes duke kërkuar që ti dorëzojnë të gjitha paisjet dhe sendet që i kanë poseduar atë ditë. Aty në vendin e ngjarjes janë intervistuar policët dhe kanë pasë për të shkuar deri në stacionin policorë në G. për ta dhënëdeklaratën . Ky ka qenë në veturëme të dyshuarin Q., ndersa H.4 dhe Sh. me të dyshuarin H.3. Duke shkuar në

drejtim të G. polici H.4 e ka thirrë që të kthehet prapë në vendin e ngjarjes. Kur ka ardh në vendin e ngjarjes ka kuptuar se nga kolëgët Sh. dhe H.4 ka qenë i informuar se polici H.3 pasi ka hyrë në vetyren e policisë ka thënë që ta hapi deren dhe të pshtyj dhe kur e ka hapë deren e kanë parë kur e ka hudh një letër të bërë duq dhe dukej si 50 € euro. I kanë fotografuar atë monedhë. Poashtu në atë vend ku ka qenë patrulla e trafikut kanë gjetë një tiketë me shenimet e ankuesit, shtetas Maqedon e berë duq dhe e hudhur prapa disa të therave. Të gjitha i ka shenuar në këtë raport dhe e ka nënshkruar duke e kompletuar rastin të cilin e ka dorëzue komadantit rajonal dhe inspektorit policorë.

Nga raporti i zyrtarit policorë Sh.A., të dt. 20.10.2012, është vërtetuar se pas marrjes së informates se një njësie trafikut regjional ka marë mito nga një palë, ka shkue me kolegët H.K. dhe V.V. në fshatin Ll. . Atykanë takue dy policë të trafikut regjional të cilët i ka intervestue, polici hetues H.K. dhe rreshteri V.V.. Pas përfundimit të intervestimit me një vetyrë zyrtare janë nisë për në stacionin policorë në D. . Zyrtari policor Sh.A. bashk me te dyshuarin H.N. është ulë në ulësen e pasme dhe para se mu nisë vetura H.3. ka kërkue me hapë deren se do të pshtynë. Ka vërejtur një levizje të dyshimt në doren e tij të djatht duke hedhur diqka dhe kur ka dal nga automjeti nga pjesa e pasme afër derës se pasme ku ka qenë i ulur polici i trafikut –H.3. në tokë ishin 50 (pesëdhjetë) euro. Lidhur me këtë e ka njoftuar udhëheqësin e ndrimit, polici hetues ka komunikuar me policin e trafikut dhe ka bërë fotografimin e monedhes, ndersa ky të gjitha i ka shenuar në raport dhe në tërsi ka mbetur pranë atij raporti, të cilin në fund e ka nënshkruar.

Nga listat e dëshmimeve të datës 20.10.2012 është vërtetuar se një monedhë e letrës prej 50 euro me numër serik M90990078223 është gjetur në vendin e ngjarjes në Ll., vendi ku është pika e kontrollit nga njësia e trafikut regjional e përbërë nga polici Q.I. me KI 0078 dhe H.N. KI 5853 e mbledhur nga H.K. “KI 6626” dhe po ashtu një fletë paraqitje për kundërvajtje në komunikacion nr. 0745023 e shqyer në dy pjesë dhe vendi i gjetjes është në tokë, pas lokalit të N.Th. në fshatin Ll. tek magjistralja Komoran- Pejë

I akuzuari Q.I. në mbrojtjen e tij në shqyrtimin gjyqësor ka mohuar në tërësi kryerjen e veprës penale duke shtuar se me datën 20.10.2012 së bashku me tani të akuzuarin H.N. në regjionin e Prishtinës dhe në veçanti në orën 11:00 ka qenë në fshatin O., Komuna e D. duke ndalur pjesëmarrësit në komunikacion dhe sa ikujtohet kanë ndalur 3 pjesëmarrës, veturat e të cilëve kanë qenë me targa të Maqedonisë përfshirë edhe tani të dëmtuarin D.R. të cilin e ka ndalur i akuzuari H.3 për shkak të tejkalimit të shpejtësisë së lejuar ndërsa që ai i’aka plotësuar tiketën – dënim për gjykatë ndërkohë këtë tiketë e ka grisur, dhe të njëjtën e ka raportuar tek personi me emrin Imer, i cili ka qenë ngarkuar me tiketa mirëpo jo në prani të personit të cilit i është shqiptuar dhe më vonë ka filluar ta përpilojë një tiketë të re me shënime të njëjta mirëpo që nuk ka arritur ta përfundojë për shkak të një aksidenti në komunikacion, dhe se duke qenë se tani dëmtuari kishte për të shkuar në fshatin G.1 dhe do kthehej pas dy ore, i ka thënë se kur të kthehesh ta lëshojmë një tiketë të cilën e paguan menjëherë në bankë. Po ashtu në deklaratën që i njëjti ka dhënë në polici me dt: 20.10.2012 ka përshkrar veprimet që ka kryer në ditën kritike mirëpo që në disa drejtime ka qenë më specifik ashtu që ka përshkruar se si kanë ndalur edhe një shtetas të Maqedonisë me emrin a.a. i cili ka qenë duke vozitur me shpejtësi 105 km/h, ndërsa që shpejtësia e lejuar ka qenë 50 km/h dhe për shkak se i njëjti ishte profesor në fakultetin juridik, në shenjë respekti i ka shënuar vetëm vërejtje.

I akuzuari H.N. në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se me dt: 20.10.2012 se ka qenë bashkë me kolegun Q.I.dhe detyra e tyre ka qenë kontrollimi I trafikut me radar, asjtu qëi njëjti e ka matur shpejtësinë e pjesëmarrësve ne trafik ndërsa që kolegu I ti j ka bërë plotësimin e tiketave dhe se i kujtohet se e ka ndaluar një person me emrin D.R.për shkak të tejkalimit të shpejtësisë dhe me të njëjtin ka biseduar në gjuhën serbe, dokumentet e të njëjtit jaka dhënë kolegut të tij, tani të akuzuarit Q. i cili është dashur t'ia plotësojë tiketën për shqiptimin e dënimit mirëpo nuk ka arritur ta bëjë këtë pasi që në atë moment ka ndodhur një aksident në komunikacion dhe e ka parë që I njëjti i'a ka dorëzuar dokumentet këtij personi dhe se nga momenti I largimit të këtij personi dhe deri te ardhja e policisë kanë kaluar dikun 1 orë e gjysmë deri në 2 dhe se gjatë asaj kohe së bashku me kolegun e tij kanë qenë për të ngrenë drekë në restorantin “B.”, dhe se në ditën kritike I njëjti ka qenë I kompletuar sa I përket blloqeve për shqiptimin e tiketave dhe se a I kujtohet në fillim kur ka filluar ti shënoj fletëparaqitjet I njëjti I ka thënë “po e shkuraj një për vete” ndërsa që ky I është përgjigjur jo se unë kam bllok dhe se nuk I'u është thënë nga i njëjti se ka probleme sa I përket bllokut të shqiptimit të tiketave. Më tutje ka shtuar se në momentin kur ka ardhur policia e ka njoftuar se një qytetar ka bërë ankesë se të njëjtit kanë marrur ryshfet dhe në atë rast tani të akuzuarit kanë shprehur gatishmëri për bashkëpunim, i'u është kërkuar që ti nxjerrin të gjitha gjësendet që kanë pasur në xhep, përfshirë edhe shumën e parave prej 13,873.30, të cilë shumëi'a kanë kthyer me dt:22.11.2012 dhe më pastaj tani dëshmitari V.V. është nisur për në stacionin policor me tani të akuzuarin Q., mirëpo të njëjtit menjëherë janë kthyer, i'a ka marrur kuletën nga dora dhe ka filluar të flas diçka. Po ashtu edhe në deklaratën e dhënë në Polici me dt.12.10.2012, i njëjti në mënyrë të ngjashme ka përshkruar rrethanat e zhvilluara në ditën kritike duke mohuar kështu në tërësi kryerjen e ndonjë veprimi të kundërligjshëm, përveç që pas momentit të ndaljes se tani të dëmtuarit D.R. për arsye të shqiptimit të tiketës për shkak të tejkalimit të shpejtësisë, i njëjti i është lutur që të mos i shqiptohet, ndërkohë që tani të akuzuarit kanë ndalur edhe vetura tjera dhe pasnjë kohe kanë shkuar për drekë në restorantin te “B.”.

Gjykata ka vlerësuar dëshminë e dëshmitarit dhe njëherit të dëmtuarit D.R. dhe të njëjtën e ka vlerësuar si dëshmi objektive, reale dhe të sinqertë dhe në përputhje me provat materiale, e nga e cila vërtetohet bindshëm fakti se tani të akuzuarit H.3 dhe Q. pasi e kishin ndaluar të njëjtin për shkak të tejkalimit të shpejtësisë dhe për të mos i shqiptuar tiketën kundërvajtëse i kishin kërkuar shumën prej 50 eurove, ndërsa që të njëjtit kërkesën e tyre e kishin legjitimuar me faktin që duhet të hanin drekë dhe tani i dëmtuari u'a kishte dhënë shumën në vlerë prej 50 euro-ve. Dëshmia e këtij dëshmitari është në përputhje edhe me provat materiale siç është kartmonedha në shumë prej 50 euro e cila është gjetur në vendin e ngjarjes pasi që është hedhur nga tani i akuzuari H.N., pastaj dëshmia e këtij dëshmitari është në përputhje edhe me faktin se tiketa të cilën dëshmitari e ka përshkruar se është grisur nga polici i cili ka qenë në veturë është e evidentuar gjoha në shumë prej 270 euro dhe shpejtësia 97 klm/h, është gjetur në gjendje të grisur dhe se shuma e gjobës së shënuar është pikërisht 270 euro siq ka pohur edhe dëshmitari, ndërsa që po ashtu siq ka pohuar dëshmitari, në këtë tiket është shënuar se i njëjti ka qenë duke levizur me shpejtësi prej 97 klm/h. Po ashtu kjo dëshmi është pjesërisht në përputhje edhe me pohimi i të akuzuarit H.N.i cili e ka pohuar faktin se tani i dëmtuari D.R. pasi që i është thënë se do t'i shqiptohet tiketa i'u është lutur të njëjtëve që të mos i shqiptohet e njëjta, pra pohimet e këtij dëshmitari në drejtime thelbësore konfirmohen edhe nga provat materiale duke bërë kështu pakontestueshme vërtetësin e të njëjtes. Po ashtu është e rëndësishme në thekësohet fakti qëme rastin e

deklarimit të dëshmitarit në polici me dt.20.12.2012, kanë qenë të pranishme edhe avokatet e tani të akuzuarve të cilët kanë pasur mundësi ta pyesin apo kundërshtoj pohimet e dëshmitarit lidhur me rrethanat konkrete në mënyren se si e ai e ka shpjeguar ngjarjen, duke përmbushur kështu kushtin e paraparë me nenin 262 par.1 të KPPK-së, që gjykata të mund të mbeshtetet për të vërtetuar fjaësin e të akuzuarit, kur kjo deklaratë është provë e vetëme apo provë kryesore. Po ashtu lëximi i deklaratës së këtij dëshmitari është bërë në përputhje me nenin 338 par 1, nënpar.1.1.të KPPK-së i cili ka parashikuar mundësin e lëximit të deklaratave të dëshmitarve atëherë kur ka pengesa në sigurimi i pranës së të njëjteve, ndërsa që gjykata ka bërë të gjitha përpjekjet e nevojshme për sigurimin e pranës së të njëjtit por që të njëjtat kanë rezultuar të pasuksesshme.

Gjykata ka vlerësuar dëshminë e dëshmitarve V.V., Sh.A. dhe H.K., dhe të njëjtat i ka gjetur dëshmi të sinqerta, objektive dhe në përputhje me njëra tjetrën dhe provat material të administruar në këtë çështje penale, e nga të cilat vërtetohet bindshëm fakti se të akuzuarit Q. dhe H.3 në ditën kritike pasi që kanë ndaluar tani të dëmtuarin D.R. për shkak të tejkalimit të shpejtësisë lejuar me qëllim që mos t'i shqiptohet tikitë për kundërvajtje i është marrur shuma prej 50 euro dhe se këtë shumë parash tani dëshmitarët e kanë evidentuar pasi që e njëjta është hedhur nga tani i akuzuari H.3, në momentin kur i njëjti ka qenë në veturën e policisë, ndërsa që dëshmit e këtyre dëshmitarve janë në përputhje edhe me raportete policore të dt.20.12.2012 të përpiluar nga të njëjtit kun ë mnëyrë të hollësishme kanë përshkruar veprimet e tyre që nga moment kur janë njoftuar lidhur me rastin, shkuarjen në vendin e ngjarjes, veprimet konkrete që kanë ndërmarrur si dhe veprimet inkriminues të kryera nga tani të akuzuarit H.N. dhe Q.I..

Gjykata ka vlerësuar edhe listat e dëshmimeve të datës 20.10.2012 dhe nga e njëjtat ka vërtetuar bindshëm faktin se monedha që është gjetur, është pikërisht e njëjta të cilën tani i dëmtuari D.R. u'a ka dhënë tani të akuzuarve me qëllim që të njëjtit të mos i shqiptonin tikitë për tejkalim të shpejtësisë ani pse edhe pasi që është shkruar e njëjta, më pastaj është shqyrtuar siq vërtetohet nga fakti se e njëjta është gjetur në tokë, ndërsa që ky fakt është në përputhje edhe me vetë veprimin e të akuzuarit H.N.që të mos ishte pikërisht kjo monedhë që e kanë marrur nga i dëmtuari D.R., nuk do të kishte arsye që e njëjta të hudhet nga i njëjti siq është vërtetuar nga dëshmia e dëshmitarit Shaip Aliu i cili ka përshkruar se si në një moment i akuzuari Hamit ka hedhur kartmonedhen në vlerë prej 50 eurove.

Gjykata bazuar në të gjitha provat e administruara ka ardhur në përfundim se në veprimet inkriminuese të akuzuarve Q.I.dhe H.N.përmbushen të gjitha elementet e vepres penale, marrja e ryshfetit në bashkëkryerje nga neni 343 parg 2 lidhur me nenin 23 të KPK –së, pasi që nga të gjitha provat e administruara gjykata ka vërtetuar faktin se të akuzuarit Q. dhe H.3 duke vepruar në cilësi të personave zyrtar si pjesëtar të policisë së Kosovës, me qëllim të sigurimit të përfitimit për vete e në bashkëpunimë, kanë pranuar nga drejtuesi i automjedit D.R. shumën e parave në vlerë prej 50 euro, në shkëmbim të mos shqiptimit të gjobës-fletëparaqitja për kundërvajtje, për shkak të tejkalimit të shpejtësisë, veprime këto të kryera në kushtet e dashjes dhe me vetdije të plotë. Sa i përket elementit të bashkëkryerjes, sipas nenit 23 bashkëkryerje konsiderohet kryerja veprës penale nga dy ose më shumë persona,duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër. Pra për tu gjendur në kushtet e bashkëkryerjes duhet të bashkekzistojnë si kushte sine qua non: dy ose më shumë subjekte, dhe siq është vërtetuar gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe është pranuar edhe nga vetë të akuzuarit I. dhe H.3 gjatë gjithë



kohës ka qenë së bashku, edhe ne momentin kur i dëmtuari është ndalur; realizimi i faktit kriminal në të gjithë elementet e tij materiale, të jetë cënuar një marrëdhënie shoqërore e mbrojtur nga ligji penal, duke ardhur objektivisht një pasojë kriminale nga veprimi ose mosveprimi shoqërisht i rrezikshëm, që ne rastin konkret rezulton e provuar se të akuzuarit kanë kryer veprën penale Marrje rryshfeti nga neni 343 par 2 lidhur me nenin 23 te KPPK-së; dhënia e një kontributi rlevant në kryerjen e veprës penale nga secili prej bashkekryeresve, qe në rastin konkeret siq është vërtetuar pakontestueshme të njëjtat kanë pasur dijen për veprimet e njëri tjetrit dhe kanë miratuar të njëjtat, ashtu që i akuzari H.3 e ka ndalur të dëmtuarin, ndërsa që ka qenë i akuzuari Q. që kundërejt marrjes së shumës prej 50 euro, ka shqyer tiketën të cilën tani më e kishte përpiluar për të dëmtuarin D.R. për shkak të tejkalimit të shpjetësis.

Gjykata ka vlerësuar edhe mbrojtjen e të akuzuarve Q. dhe H.3, mirëpo të njëjten e ka gjetur të pabazuar dhe në funksion të ikjes nga përgjegjësia penale për veprën penale për kryerjen e të cilës janë akuzuar. Sa i përket mbrojtjes së të akuzuarit Q., e njëjta është në vetë vetë kundërthenëse pasi që i njëjti ndryshe nga shqyrtimi gjyqësor ku ka pranuar se kanë ndalur një person nga Maqedonia me emrin D.R., në deklaratën që ka dhënë në polici ka deklaruar se personi nga Maqedonia që e kanë ndalur ka pasur emrin A.A., ndërsa që nuk ka përmendur fare se ka pasur problem me bllok të tiketave që ka përdorur për shqiptimin këndërvajtjeve, ani pse duke pasur parasyesh se deklaratën në polici e ka dhënë me dt.20.12.2012 pra ditën kur ka ndodhur ngjarja, është dashur që këto rrethana të i kujtohen më mirë, duke qenë se kujtesën e ka pasur me të freskët, mirëpo ndryshimi në deklaratat e këtij të akuzuarit është rrjedhojë e faktit që pasi që është vënë në dijeni për gjetjen e tiketës së shqyer dhe evidentimin e emrit D.R. në të njëjten, ndërkohë që tani ka pretenduar se tiketa e shqyer është rrjedhojë e fakti se ka pasur problem me bllokun e tiketave, ndërsa që tiketën të dëmtuarit D.R. do i'a shqiptonte pasi që ai do kthehej pas dy ore nga fshatin G.1, ku ishte duke shkuar. Gjykata vlerëson se të gjithë këto pretendime janë pjell e imagjinates së të tani të akuzuarit I., i cili si duket nuk e ka pasur imagjinatën kaq të pasur në momentin e dhënies së deklaratës në polici, kur këto rrethana nuk i ka përmendur fare, e sigurisht nuk i ka përmendur se nuk kanë ekzistuar, ndërsa që nga atëherë e deri me rastin e deklarimit në shqyrtimin gjyqësor ka pasur kohë të mjaftueshme të përpunojë mbrojtjen e tij duke e pasuruar edhe me rrethana të tilla të paqena, qenia e të cilave nuk konfirmohet me asnjë provë në realitetin e fakteve, nga i cili realitet duket se i akuzuari Ibish është shkputur tërësisht. Këto pretendime të akuzuarit I., nuk janë fare në pajtim me mbrojtjen e të bashkëakuzuarit H.N. me të cilin ka vepruar, pasi që i njëjti ka heq dorë nga dija mbi realitetin, duke pretenduar mosdijen e tij se cka ka biseduar dhe si ka vepruar kolegu i tij tani i akuzuari Ibish me rastin kur pasndaljes se të dëmtuarit D.R., i njëjti është dërguar tek ai për shqiptimin e tiketës, e që ky pretendim është i paqëndrueshme pasi që siq është vërtetuar bindshëm nga deklarata e të dëmtuarit D.R., para se tani të akuzuarit të i kërkojnë shumën prej 50 euro, kanë biseduar ndërveti duke vërtetuar kështu se kerkesa për shumën prej 50 euro është bërë në pajtim në mes tyre, ndërsa që po ashtu siq është vërtetuar nga dëshmit e dëshmitave, në veqanti nga dëshmitari Sh.A., i akuzuari H.3 ka hedhur kartmonedhen në shumë prej 50 euro, kartmonedh të cilën i dëmtuari D.R. ka pohuar se ua ka dhënë të njëjtesve, ndërsa që i njëjti nuk ka pasur asnjë arsye për një veprim të tillë, përveq fakti që ka qenë në djeni së kjo shumë është dhënë nga tani i dëmtuari D.R. dhe si e tillë nuk duhet gjetur në posedim të tani të akuzuarit, duke qenë se koleget e tyre, të dërguar në cilësin e dëshmitarve në këtë çështje penale kishin ardhur në vëndin e ngjarjes pikërisht

pas ankeses së të dëmtuarit D.R.. Ndryshim thelbësor në mbrojtjen e tani të akuzuarve I. dhe H.3, brenda vetes dhe në raport me njëri tjetër, provon po ashtu paqëndrueshmëri e tyre, pasi që përtej të gjithave e vërteta lidhur me një ngjarje është vetëm një, anipse mund të ketë dallimi në përshkrimin e të njëjtit deri në një pikë qështë e lejueshme duke i nisur nga fakti i kalimi të kohës nga ngjarja, pozicioni në momentin e fillimit të ngjarjes, e po ashtu edhe forca e mbamendjes, ndërsa që tjetërsimi i të vërtetes mund të bëhet në shumë versione, e që kjo kushtëzohet nga forca e imagjinates që gjithësecilit që siq është rasti me të akuzuarin I. i cili ka tjetërsuar në tërësi realitetin duke mos lënë asnjë fije lidhje me të njëjtin.

Gjykata gjatë matjes së denimit të akuzuarve iu mori të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e denimit konform nenit 73 të KPPK –së , për të akuzuarin Q.I.si rrethanë lehtësuese mori faktin se i njëjti është i gjendjes së dobët ekonomike, jo i punësuar, i martuar dhe babai i tre fëmijëve, më parë jo i gjykuar, ndaj tij nuk zhvillohet procedurë për ndonji vepër tjetër penale, ndërsa që për të akuzuarin H.N. si rrethanë lehtësuese ka marrë se është pa punë, i martuar, babai i ... fëmijëve, ma parë jo i gjykuar dhe ndaj tij nuk zhvillohet procedurë për ndonjë vepër tjetër penale dhe për dy të akuzuarit morri si rrethan lehtësuese edhe faktin periudhes së gjatë nga koha e kryerjes së veprës penale, ndërsa që rrethana rënduese nuk ka gjetur. Andaj, gjykata vlerëson se dënimet e shqiptuara janë në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarve, intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, dhe në këtë mënyrë do të ndikojë në parandalimin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëjë rehabilitimin e të njëjtëve, si dhe do të përmbajë persona të tjerë nga kryerja e veprave penale, çka është edhe qëllimi i dënimit nga nenit 34 të KPPK-së.

Vëndimi për udhëzimin e palës demtuar D.R.në kontest civil bazohet në nenin 463 paragraf 2 të KPPK-së.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata morri konform dispozitave të nenit 450 paragraf 2 nën.paragraf 2.6 të KPPK-së.

Nga se u çek ma lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**  
**PRKR.nr.179/15, të dt: 12.06.2018**

**Bashkëpunëtori profesional**  
**Driton Berisha**

**Kryetarja e trupit - gjyqtarja,**  
**Shadije Gërguri**

**KESHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 8 /tetë/ ditë nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj Gjykate.